



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria Për Mbrojtje dhe Shpëtim

Odelenje za Zastitu i Spasavanje

Department for Protection and Rescue

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

Odelenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 714 Më 12.03.2019
Br. prot. Dt. 12.03.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

Protokoli/Protokol/Protocol Nr.

Lëshuar nga/Puštено od/Released from:

Përgaditur më/Pripremljenodana/Prepared at: 12.03.2019

Për/Za/To : Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Përmes/Preko/Over:

Nga/Od/From: z. Hasan Përboqi, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

Lënda/Predmet/Subject: Vetëdijësimi i qytetarëve dhe parandalimi i zjarreve.

Informatë

Ditët e fundit përshkak të kushteve të thata të motit dhe ajrit, po rezultojnë edhe me paraqitjen e zjarreve në disa zona malore, fushore e poashtu edhe afër vendbanimeve. Duke pasur parasysh pasojat që mund të vijnë nga shpërthimet e zjarreve, dalja eventuale jashtë kontrollit e tyre, paraqet rrezik edhe për jetën e njerëzve.

Në vijim po ju informoj me numrin e zjarreve që kanë ndodhur për periudhën **21.02-10.03.2019**, numri i përgjithshëm ka qenë **43 zjarre**.

Zjarre në objekte	Zjarre fushore	Zjarre Malore	Total
3	28	12	43 zjarre

Këto ditë edhe vetë ju jeni dëshmitarë që ka zjarre të shumta, shumica e të cilëve shkaktohen edhe nga dora e faktorit njeri. Njësia e zjarrfikjes së bashku me inspektorin për mbrojtje nga zjarri, policinë dhe sektorin e pylltarisë vazhdimisht janë në terren duke u munduar që të mos lejohet që situata të na dalë jashtë kontrollit.

Mes natës së datës 6 dhe 7 Mars diku rreth orës 1:20 njësia e zjarrfikjes ka pranuar thirrje nga policia e Kosovës se një objekt në vendin e quajtur "Epopeja e Rahovecit" ka zjarr në shtëpizën turistike që kanë qenë e ndërtuar në atë pjesë, fatkeqësisht njësia e zjarrfikjes nuk ka mundur të

e lokalizojë zjarrin, djegjes së shpejtë i ka kontribuar materiali prej druri që ka qenë i ndërtuar objekti, me gjasë në këtë objekt ka pasur zjarrvënje të qëllimishme nga persona të papërgjegjshëm.

Ne si institucionet e dënojmë këtë veprim qyqar dhe aspak të mirë, dhe shpresojmë në zbardhjen sa më të shpejtë të këtij rasti dhe të dënohen konform ligjeve në fuqi ata që e kanë bërë këtë vepër qyqare.

Nga këtu apelojmë tek qytetarët të jenë të kujdesshëm dhe vigjilent në përdorimin e mjeteve ndezëse dhe të e ruajnë pronën publike sepse ajo është e të gjithë neve, kujdes me zjarre që të mos vijë deri tek ndonjë rrezik për jetën e qytetarëve.

Me Respekt:

Hasan Përboqi

